



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 2134 / 12 prot.

Gramsh, më 05/07/2021

VENDIM

Nr. 75, datë 29.06.2021

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË GRAMSH, NR 37 DATË 17/10/2005 "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË GRAMSH, TË QARKUT ELBASAN", I NDRYSHUAR, SI DHE PËR NJË SHITESË NË LISTEN E INVENTARIT TË PRONAVE PALUAJTSHME DHE PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA GRAMSH, TË PRONËS NR. 1439 "ME EMËRTIM "ISH REPART USHTARAK", ME VENDNDODHJE NË ÇEKREZ, FASHATI KOÇAJ, BASHKIA GRAMSH, PËR NDERTIMIN E VARREZAVE TË REJA TË QYTETIT GRAMSH.

Këshilli i Bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës , 29 / 06 / 2021 , pasi mori në shqyrtim Relacionin dhe P/Vendimin nga Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Menaxhimit të Aseteve ,në zbatim të ligjit nr,8743,datë ,22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit "të ndryshuar ,neni 3 të ligjit nr,8744, date 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të palujtshme publike të shtetit në njësit e qeverisjes vendore " të ndryshuar, referuar VKM-së nr, 431 datë , 11.07.2007 " Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtshme publike ,shtetërore, që transferohen , në pronësi ose në përdorim ,të Bashkisë , Gramsh , të qarkut Elbasan i ndryshuar, të vendimit nr, 500, datë 14.08.2001 të Keshillit të Ministrave "Për inventarizimin e pronave të Palujtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në njësit e qeverisjes vendore "të ndryshuar ,udhëzimit nr.15,datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësia e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike " Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.2, shkronja "a", nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", me Propozimin të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

V E N D O S I:

- I. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Gramsh, të pronës nr. 1439 me emërtim "Ish repart ushtarak", me vendndodhje në Çekrez, fshati Koçaj, Gramsh, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur në fushën e shërbimit funeral, për ndërtimin e varrezave të reja të qytetit Gramsh dhe efektet financiare që rrjedhin nga zhvillimi i pronës sipas projektit, të

përballohen nga Bashkia Gramsh.

- II.** Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, të miratuar dhe që i bashkëlidhet vendimit nr. 431, datë 11.07.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas miratimit me VKM të kërkesës për kalim në pronësi të Bashkisë Gramsh, të shtohet prona nr.1439 me emërtim “Ish repart ushtarak”, me vendndodhje në Çekrez, fshati Koçaj, Gramsh, sipas Lidhjes së mëposhtëme nr.1 dhe formularit standart të inventarizimit nr. 1 bashkëlidhur vendimit.

Bashkia Gramsh

Lidhja nr, 1

Numri rendor i pronave në Listen e inventarit	Fusha e Përdorimit të Pronës	Lloji i transferimit
521-526	Prona që përdoren për shërbime funeral	Në pronësi

Lista e inventarit të pronës së paluajtshme, fillon me numrin rendor 521 (Pesqind e njëze e një) dhe përfundon me numrin rendor 526 (Pesëqind e njëzetë e gjashtë) dhe ka gjithsej 2 (dy) fletë.

III. Bashkisë Gramsh i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

IV. Paraqitja e materialit pranë Ministrisë së Mbrojtjes e cila ka pronën në përgjegjësi administrimi dhe për dërgimin prej saj për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave.

V. Bashkëlidhur formularin nr.1, i inventarizimit të pronës.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Drejtoria e Planifikimit të Territorit (Sektorit të Menaxhimit të Aseteve Vendore) Drejtoria e Shërbimit Publike dhe Evergjencat Civile Bashkia Gramsh .

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes !

Sekretari i Këshillit të Bashkisë
Xhulia GJINI

Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Doxja nr:
Afati i ruajtjes: RHK

Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Greta LENA

